



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot

Gjirokastrë, më _____.____.2025

PROCESVERBAL

**MBI HARTIMIN E KRITEREVE PËR PJESMARRJEN NË TENDERIN ME
OBJEKT**

“BLERJE PJESE KEMBIMI PER AUTOMJETE”

FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

SPECIFIKIME TEKNIKE

I mbajtur sot me date _____.____.2025 në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë Sh.a nga Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhërin Nr. ___, Datë _____.____.2025, i përbërë nga Anxhela Mustafaj, Arqile Puleri, Denisa Ahmati **për prokurimin me objekt “Blerje pjese kembimi per automjete ”**

Grupi i punës mbështetur Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, dhe në vkm nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 25 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedure prokurimi. Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.

Kriteret e veçanta të kualifikimit neni 34 si dhe neni 41 kushtet e veçanta të kontratës përkufizojnë tërësinë e punëve që do të kryhen, të gjitha mallrat apo shërbimet që do të furnizohen, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet autoritetit/entit kontraktor dhe kontraktorit, si dhe detyrimet për përmbushjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës.

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë mbështetur në nenin 39 pika 6 gërma b që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës

Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon Operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- > Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- > Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai

i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shënim: Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 nenit 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë SHRUKGJ sh.a dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Në rast se operator është ekonomikë të kualifikuar i pari janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës janë krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe deklaratën për caktimin e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Slënit: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 7

1.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar¹:

1.1.3- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% e fondit limit.

1. **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pilot 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

3. **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

4. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;

VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike ". Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave tëprokurimitpublik".

2. 3.Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

5) Vërtetim të lëshuar nga autoritete vendore për shlyerjen e taksave vendore , paraqitjen e formularit të vetedeklarimit

1. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB.
5. 3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022-2023 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendorë" (i ndryshuar);
6. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR.
7. **Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimitpublik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*
8. *Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2020 sipas kështëve pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e*
9. *aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshrimi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më shumë se 20% e fondit limit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në ftiqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKMnr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

c) Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

- Te gjitha zerat e riparimit perfshire dhe pjeset e kembimit qe do te montohen gjate riparimit te automjeteve te kerkuara dhe paraqitura nga ofertuesi shtojca nr.2 (oferta ekonomike).Nga ofertuesi duhet te plotesohen rigorozikisht kodii origjines I pjeseve qe do te montohen gjate ripaimit per te gjitha zerat qe do te riparohen.Ne kete table cdo operator eshte I detyruar te japi cmimin e sherbimit per te gjitha zerat e tableles.

- Operatori ekonomik duhet te kete te pakten nje servis brenda territorit administrativ te Bashkise Gjirokaster , te vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronesie ose kontrate noteriale qeraje).Ndersa per defekte te vecanta ato mund te kryhen ne servise te specializuara,por gjithmone nen pergjegjesine e OE fitues Pika e seivisit te jete e pasqyruar ne Ekstraktim e QKB-se se OE pjesmarres ne tender.Servisi i OE duhet te jete i kompletuar me pajisjet e nevojshme per kryerjen e riparimeve dhe sherbimeve sipas tabelave te specifikimeve teknike te cdo automjeti.Servisi i automjeteve duhet te jete i pajisur si me poshte:

a)Me 1 ose 2 ura riparimi (poste riparimi), pajisje vegla pune profesionale per te gjitha llojet e riparimeve(pajisje per kontrole testimi te sistemit elektrik dhe defekteve ne motor te automjetit, pajisje per kontrollin dhe testimin elektronik te sistemit te frenimit, pajisje per kontrollin dhe balancimin e disqeve dhe gomave,pajisje per ndrimin e alkolit per sistemin e frenimit, kompjuter per diagnostifikimin e automjeteve)

- Operatori ekonomik ofertues te kete ne stafin e tij te punesuar ne funksion te realizimit te objektit te prokurimit punonjes te vertetuar me deshmite perkatese (njeri nga punonjesit te jete detyrimisht inxhinier mekanik, nje motorist, Ixhenerik-mekanik dhe nje elektroaut), duke e vertetuar kete pike me paraqitjen e listave te punonjesve me profesionet perkatese qe ushtrojne si dhe me ane te paraqitjes se listpagesave te sigurimeve shoqerore te konfirmuara nga tatimet per 3 muajt e fundit ,ku punonjesit me profesionet perkatese sa me siper te jene detyrimisht te pasqyruar ne to.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te provoje se disponon License per ushttrimin e veprimtarise leshuar nga QKB.

- Operatori ekonomik ne rast se lind nevoja ben sigurimin e karotrecit me shpenzimet e tij per rregullimin e defekteve.Sherbimet do te kryhen ne servisin e OE fitues dhe ne rast kur automjeti duhet te transportohet me karotrec ne qendren e servisit shpenzimet per mjetin transportues dhe transport! do te perballohen nga ofertuesi brenda cmimit te ofertes.

- Operatori te siguroje nje periudhe garancie prej 6 muajsh per punen e riparimit te kryer dhe materialet e perdorura. Pasojat e mirembajtjes me cilesi te dobet te kryer gjate periudhes se garancise rregullohen nga OE falas. Pas cdo riprimi automjeti te shoqerohet me flete garanci me nje afat kohor 6 muaj nga data e kryerjes se riparimit ,per riparimet xhenerike dhe 12 muaj per riparimet motorike.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i certifikuar sipas standarteve per aktivitetin qe ushtron lidhur me riparimin e automjeteve. Per sa me siper operatori duhet te paraqese certifikatat perkatese perkatesisht certifikatën e vlefshme te leshuar nga organizma te akredituara, qe vërteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë së tij është në përputhje me ISO 9001:2015 dhe objekti i saj të përputhet me objektin e prokurimit.

Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Nenit 79, pika 1 të ligjit nr 162 dt 23.12.2020 per “Prokurimin publik” si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 44 ku cilësohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objektprokurimi, iplotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

- Kërkesat e cilësisë, pika 1 ISO 9001:2015:

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e investimit/kontratës.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që qfron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhnr ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dështon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Operatori ekonomik ne oferten e tij duhet te plotesoj te gjitha kushtet dhe kerkesat e vendosura ne Specifikimet teknike, dhe kur kerkohet, per te provuar perputhshmerine e produktit te ofertuar me kerkesat te paraqese certifikatat apo dokumentat provues ne varesi te produktit dhe kerkeses.

• Gjithashtu me levrimin e mallit, furnizuesi duhet te paraqese:

1. Fature tatimore
2. Deklarate Garancie nga ofertuesi i mallit ose prodhuesi

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

2.2.4 Në bazë të Ligjit Nr 162 datë 23.12.2020 “ Për ligjin e prokurimeve publike ”

Neni 83 pika 2

2. Operatori ekonomik i suksesshem duhet të dorëzojë:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti kontraktor, specifikon se Operatori ekonomik duhet të paraqesë sigurimin e ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të:

a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;

b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit.

c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar.

Të gjitha dokuinentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë , patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe equivalent i tyre.

SPECIFIKIME TEKNIKE

“Shpenzime per riparim dhe sherbim per automjete”

Specifikimet teknike te gomave te automjetit qe do te prokurohen

1 .Gomat te jene te reja (te pa riveshura)

2 .Ne siperfaqet anesore , cdo gome duhet te kete te stampuara keto te dhena:

- Prodhesi (marka)
- Emertimi i gomes
- Permasat e gomes sipas kerkesave dhe profilet e batistrades
- Indeksi i ngarkeses dhe i shpejtesise
- Struktura e gomes (radiale ose diagonale)
- Tipi i gomes (Tubeless/Tube type)

• Numri i miratuar UN/ECE i prodhuesit te gomes (tregon se prodhimi i gomave behet ne perputhje me rregullat e vendosura nga UN/ECE).

- E (standard BE) ose DOT (standard amerikan)
- Kodi i prodhuesit te gomes
- Kodi i gomes (per shembull EA -kodi i gomes 255/60R17,165/80R13
- Data e prodhimit (per shembull 1009-prodhuar ne javen e e dhjete te vitit 2009

3 .Te jene te prodhimit jo me heret se 6 muaj nga data e zhvillimit te tenderit

4 .Gomat e nje dimensionit te jene te gjitha te te njejt tip prodhimi

Garancia jo me pak se 40 000 (dyzet mije) kilometra . Shoqerite gjate periudhes se garancise jane te detyruara te kryejne zevendesimin e gomave me difekt per shkak te prodhimit ose cilesise se dobet, pas marrjes se njoftimit nga enti prites i mallit.

Specifikimet teknike te baterive

1 .Baterite te jene prodhimi i komunitetit European

2 .Te jene me sy jo me tapa

3 .Te jene me garanci 24 mujore (shoqeruar me flete garancine).

Per te gjitha zerat e preventivit per riparimin e mjeteve do te kryhen procedurat:

- Cmontim i pjeses se demtuar
- Montim i pjeses se kembimit te re
- Te gjitha materialet dhe pjeset e kembimit do te jene te reja dhe origj inale sipas tipit te automjetit
- OE duhet te kryje kontroll teknik te automjetit ne cdo kohe .Riparimi do te behet menjehere ne momentin e paraqitjes ne servis.
- Dorezimi i automjeteve per kryerjn e sherbimeve do te jene sipas urdherit te Titullarit te AK ose personit te autorizuar prej tij. Po ashtu edhe per personat qe marrin ne dorezim automjetet e riparuar.
- Pjeset e kembimit te jene te reja dhe origjinale dhe ne pershtatje me marken e automjetit pa modifikime.

Kur automjeti mberrin ne servis per te perfituar sherbimet e riparimit behet menjehere indetifikimi i defekteve shoqeruar me procesverbal te dorezimit te automjetit ne servis.Ne perfundim te riparimit te krijohet procesverbali perfundimtar (marrjes te automjetit nga servisi)mbi kryerjen e punimeve, cdo fature sherbimi shoqerohet me fleten e garancise ku do te dokumentohet qarte data e filimit dhe mbarimit te garancise

NJËSIA E PROKURIMIT

Anxhela Mustafaj

Nelson Sejdo

Denisa Ahmati

MIRATOI

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Gentian LLOGO